



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1032 Prot.

Tiranë, më datë 09.11.2020

**VENDIM**

**Nr. 394, datë 06.11.2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, V.K.M.-së Nr. 793, datë 7.10.2020 dhe V.K.M. Nr. 792, datë 7.10.2020, pas shqyrtimit më parë të kërkesës në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 06.11.2020,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e formatit të licencave për individë/person fizik/ person juridik për veprimtari në fushën e trashëgimisë kulturore;
2. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**

**Elva MARGARITI**

**SEKRETAR**

**Arta DOLLANI**